

# LegalNews

Maj 2018  
May 2018



**I. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 286, datë 21.05.2018 "Për disa rregulla të veçanta për punëmarrësit e përkohshëm, të cilët punësohen nga agjencitë e punësimit të përkohshëm".**

Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr.286, datë 21.05.2018, "Për disa rregulla të veçanta për punëmarrësit e përkohshëm, të cilët punësohen nga agjencitë e punësimit të përkohshëm" ("**Vendimi**").

Vendimi është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 76, datë 28.05.2018 dhe ka hyrë në fuqi menjëherë pas botimit.

Vendimi zbaton dispozitat e neneve 18, pika 2, dhe 18/1, pika 5, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar, dhe përmban, ndër të tjera, specifikime mbi rastet kur punësimi në Agjencitë për Punësim të Përkohshëm ("**Agjencia**"), është i ndaluar si dhe rastet kur ky lloj punësimi mund të realizohet.

Në bazë të këtij Vendimi, punëmarrësve të përkohshëm u sigurohet i njëjti akses për t'u trajnuar me qëllim përmirësimin e aftësive dhe të njohurive të tyre për fushën e pozicionit ku janë punësuar, ashtu si edhe punëmarrësve të përhershëm.

Për më tepër, sa i përket rasteve kur punësimi i përkohshëm përmes Agjencive është i lejuar, Vendimi përcakton rastet si vijon:

- zëvendësimi i një punëmarrësi, i cili mungon përkohësisht;
- rritje e përkohshme e vëllimit të punës;
- rritje stinore e vëllimit të punës;

**I. Decision of Council of Ministers no. 286, dated 21.05.2018 "On some special rules for the temporary employees, who are employed by temporary employment agencies".**

Council of Ministers approved the decision no.286, dated 21.05.2018 "On some special rules for the temporary employees, who are employed by temporary employment agencies" ("**Decision**"). The Decision has been published with the Official Gazette no. 76, dated 28.05.2018, and entered into force immediately after its publication.

The Decision implements provisions of articles 18, point 2, and 18.1 point 5, of law no. 7961, dated 12.7.1995 "The Labor Code of the Republic of Albania" as amended, and provides for, *inter alia*, specifications on cases when employment in Temporary Employment Agencies ("**Agencies**") is prohibited as well as cases when such employment can be performed.

According to this Decision, temporary employees are provided with the same access to training for the purposes of improving their skills and knowledge in the field of employment where they are employed, as that provided to permanent employees.

In addition, with regard to the cases when the temporary employment by the Agencies is permitted, the Decision determines the following cases:

- the replacement of an employee, who is temporarily absent;
- the temporary increase of the volume of work;
- the seasonal increase of the volume of work;

- realizimi i një projekti me afat të përcaktuar;
- realizimi i një projekti jashtë veprimtarisë që kryen ndërmarrja pritëse.

Nga ana tjetër, punësimi i përkohshëm është i ndaluar në rast se:

- me anë të punësimit zëvendësohen punëmarrës, të cilët ushtrojnë të drejtën e grevës;
- punëdhënësi, gjatë 6 (*gjashtë*) mujorit të fundit ka kryer largime nga puna të punëmarrësve me të njëjtin profesion, për arsye ekonomike ose, gjatë 12 (*dymbëdhjetë*) mujorit të kaluar, ka kryer largime kolektive nga puna, për të njëjtat profesione;
- puna, për shkak të natyrës së saj, paraqet rrezik për shëndetin dhe sigurinë e punëmarrësit.

Vendimi përcakton detyrimin për çdo Agjenci, për të njoftuar çdo gjashtë muaj ministrinë përgjegjëse për çështjet e punësimit, për strukturën dhe veprimtarinë e saj.

- the realization of a project having a specified duration;
- the realization of a project outside the activity of the host company.

On the other hand, the temporary employment is prohibited in case where:

- by means of this employment, there is a replacement of employees who are exercising the right to strike;
- during the last 6 (*six*) months the employer has dismissed employees having the same profession, for financial reasons or, during the last 12 (*twelve*) months the employer has made collective dismissals, for the same professions;
- due to its nature, the job presents risks for the health and safety of the employees.

The Decision sets out the obligation for any Agency to notify the ministry responsible for labor, every six months on its structure and its activity.

## Deloitte Contacts

### **Olindo Shehu, CPA**

Partner | Tax & Legal Services  
Deloitte Albania sh.p.k

Rr. "Elbasanit", Pallati prane Fakultetit  
Gjeologji Miniera  
Tirana | Albania  
Mob: +355 68 60 33 116  
E-mail: [oshehu@deloitteCE.com](mailto:oshehu@deloitteCE.com)

### **Disclaimer:**

This publication contains general information only, and none of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, any of its member firms or any of the foregoing's affiliates (collectively the "Deloitte Network") are, by means of this publication, rendering accounting, business, financial, investment, legal, tax, or other professional advice or services.

This publication is not a substitute for such professional advice or services, nor should it be used as a basis for any decision or action that may affect your finances or your business. Before making any decision or taking any action that may affect your finances or your business, you should consult a qualified professional adviser. No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

\*\*\*

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see [www.deloitte.com/al/about](http://www.deloitte.com/al/about) for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touché Tohmatsu Limited and its member firms.

Deloitte provides audit, tax, consulting, and financial advisory services to public and private clients spanning multiple industries. With a globally connected network of member firms in more than 150 countries, Deloitte brings world-class capabilities and deep local expertise to help clients succeed wherever they operate. Deloitte's approximately 263,900 professionals are committed to becoming the standard of excellence.